

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga koreografia dhe mesazhet e tifozëve te debutimi i Osmanit e festa e Muriqit – 10 momente të veçant a nga Kosova–Irlanda
ADRESA	https://albeu.com/sport/nga-koreografia-dhe-mesazhet-e-tifozeve-te-debutimi-i-osmanit-e-festa-e-muriqit-10-momente-te-vecanta-nga-kosova-irlanda/1026485/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 22:29:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 22:27:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0aa12492042ed05975f6b13154497ced7a745e4ee23cb6d6d07ad33a8ffad23e
TEKSTI	d2d234166df7fd00351b6e3641913ad84f72cdbced3a417f9ec4551e40a48d85
PAMJA	6f1f73ee95f7ebfecedb7f9d74fc9a3c65af7dc328addd18fabc01a5329d22ea

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c258944d41d3dddfcf3b3b879579ce61697fd2e8ee08cd6ab5b12bb4ffa8f58c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7e8f58ee4cb2395004ba4e7b3b4f3dd1e22873ff832ca22992256c71ea768571
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c258944d41d3dddfcf3b3b879579ce61697fd2e8ee08cd6ab5b12bb4ffa8f58c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga koreografia dhe mesazhet e tifozëve te debutimi i Osmanit e festa e Muriqit – 10 momente të veçanta nga Kosova–Irlanda



Takimi Kosovë–Irlandë, i zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”, solli shumë më tepër se një përballje 90-minutëshe futbolli. Atmosfera në tribuna, mesazhet e tifozëve, të ftuarit specialë dhe momentet vendimtare në fushë i dhanë mbrëmjes një ngjyrim të veçantë.

Stadiumi i Prishtinës ishte i mbushur me emocione që nga paraqitjet para startit deri në vërshtëllimën përfundimtare. Në mesin e të pranishmëve ishin kryeministri Albin Kurti dhe presidenti i FSHF-së, Armando Duka, ndërsa festa kulmoi pas golit të Vedat Muriqit.

Telegrafi sjell 10 momente nga prapaskenat e ndeshjes që mund të kenë kaluar pa u vënë re gjatë transmetimit.

1. Tifozët mbushën “Fadil Vokrin” shumë përpara ndeshjes

Tribunat nisën të mbusheshin herët, si nga mbështetësit e Kosovës, ashtu edhe nga tifozët irlandezë. Zhurma dhe entuziazmi u rritën gradualisht, duke paralajmëruar një mbrëmje të veçantë në stadium. Për Kosovën ishte ndeshja e parë në edicionin e ri të Ligës së Kombeve, ndërsa pritshmëritë ishin të larta pas një periudhe të shoqëruar me mungesa dhe ndryshime në përfaqësues.

2. Koreografia e “Dardanëve” përcolli një mesazh të fuqishëm

Pak çaste para fillimit, tifozët “Dardanë” shpalosën koreografinë e tyre, e cila tërhoqi vëmendjen e gjithë stadiumit. Ajo lidhej me ish-pjesëtarët dhe ish-krerët e UÇK-së të dënuar nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Në tribunë u shfaqën fjalët “Unitet. Çlirim. Krenari”, të vendosura në mënyrë që të formonin edhe inicialet UÇK.

3. Albin Kurti e ndoqi ndeshjen pasi mbërriti me vonesë

të fundit /



Erblin Osmani vendos rekord te Kosova, debutimi i 17-vjeçarit...



Horoskopi 25 Shtator/ Dashuri dhe debate, zbuloni surprizat e...



Foda analizon fitoren ndaj Irlandës dhe paralajmëron përballj...



“Koha do të tregojë çdo gjë”/ Vjen reagimi i Klodit pas Elijones: N...



Kurti për fitoren e Kosovës ndaj Irlandës: “Dardanët” zhvilluan...



Muriqi shënon golin e fitores dhe përcejll mesazh për çlirimtarë...



Rashica: Nëse vazhdojmë me këtë ritëm, jemi në rrugën ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ishte një nga figurat e pranishme në tribunen VIP. Megjithatë, ai nuk ndoqej në stadium në momentet e para të takimit dhe mbërriti pasi ndeshja kishte nisur, duke ndjekur nga afër pjesën e mbetur të saj.

4. Armando Duka u bë pjesë e një fotografie me drejtuesit e Kosovës

Në "Fadil Vokrri" ishte i pranishëm edhe presidenti i FSHF-së dhe zëvendëspresidenti i UEFA-s, Armando Duka. Gjatë ndeshjes ai u fotografua me kryeministrin Albin Kurti dhe presidentin e FFK-së, Agim Ademi.

Më vonë, Duka publikoi fotografinë dhe uroi "Dardanët" për paraqitjen e tyre.

5. Erblin Osmani debutoi me përfaqësuesen seniore

Një prej zhvillimeve të veçanta ishte paraqitja e parë e Erblin Osmanit me ekipin A të Kosovës. Futbollisti i Bayern Munichut, 17-vjeçar, ishte grumbulluar për herë të parë me përfaqësuesen seniore, pasi më herët kishte luajtur për grupmoshat e Gjermanisë.

Osmani u aktivizua në minutën e 87-të, duke regjistruar kështu debutimin e tij me Kosovën.

6. Kosova krijoi raste, por pjesa e parë u mbyll pa gola

Kosova e nisi ndeshjen me ritëm dhe ndërtoi disa mundësi të rrezikshme, por Irlanda arriti ta përballojë presionin gjatë pjesës së parë. Vedat Muriqi ishte pranë golit, ndërsa goditja e tij me kokë u ndal nga portieri irlandez.

Edhe pas pushimit, loja mbeti e hapur dhe tensioni në tribuna shtoej me kalimin e minutave. Irlanda pati shumë pak rrezik në sulm dhe, sipas raportimeve pas ndeshjes, regjistroi vetëm një goditje në kuadrat.

7. Muriqi realizoi në minutën e 83-të dhe ngriti në këmbë stadiumin

Goli i shumëpritur erdhi në minutën e 83-të. Pas një aksioni të Kosovës, goditja e Ermal Krasniqit u përplas në traversë, ndërsa Vedat Muriqi reagoi menjëherë dhe me kokë e dërgoi topin në rrjetë për rezultatin 1:0.

Pas këtij momenti, "Fadil Vokrri" shpërtheu në festë.

8. Festa e golit u shoqërua me mesazhin "Drejtësi për Çlirimtarët"

Pas realizimit, Muriqi dhe bashkëlojtarët e tij shfaqën një fanellë të bardhë ku shkruhej "Drejtësi për Çlirimtarët". Kapiteni e ngriti fanellën përpara tifozëve, duke i dhënë golit një domethënie përtej aspektit sportiv.

Mesazhi lidhej me dënimet e fundit të ish-krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

9. Pas avantazhit, Kosova kërkoi edhe golin e dytë

Avantazhi nuk bëri që Kosova të tërhiqej. Pak çaste pas golit, Ermal Krasniqi pati mundësi të artë për të dyfishuar rezultatin, ndërsa pranë realizimit ishte edhe Veldin Hoxha.

Mërgim Vojvoda provoi gjithashtu të shënonte, por tentativa e tij u ndal nga portieri irlandez. Në tribuna, çdo aksion i vendasve pritej me reagime të forta nga tifozët.

10. Foda lavdëroi mbrojtjen pas fitores

Me vërshtëllimën e fundit, Kosova siguroi fitoren 1-0 dhe tri pikët e para në Ligën e Kombeve. Pas ndeshjes, përzgjedhësi Franco Foda u shpreh i kënaqur me paraqitjen e skuadrës, duke veçuar organizimin në fazën defensive.

"Sot më pëlqeu reparti defensiv. Nuk krijuan asnjë mundësi irlandezët".

Fitorja tregoi se mbrojtja e përbërë nga Lumbardh Dellova, Ilir Krasniqi dhe Albion Hajdari arriti ta kompensojë mungesën e ish-kapitenit Amir Rrahmani.

Vlerësimi i Fodës erdhi pas një takimi ku Kosova e mbajti portën të paprekur dhe mori tri pikët falë golit të Vedat Muriqit.

Shtuar më 25.09.2026 00:27

Tags: [Kombëtarja e Kosovës](#), [Liga e Kombeve](#)






Erblin Osmani vendos rekord te Kosova, debutimi i 17-vjeçarit vlerësohet n...



Foda analizon fitoren ndaj Irlandës dhe paralajmëron përballjen e ndryshme m...



Muriqi shënon golin e fitores dhe përcjell mesazh për çlirimtarët, stadiumi...



Rashica: Nëse vazhdojmë me këtë ritëm, jemi në rrugën e duhur – ndaj...



Vojvoda pas fitores ndaj Irlandës: Liga e Kombeve ka rëndësi për play-offin ...



Hajdari: Kosova synon fitoren edhe ndaj Austrisë



Zhegrova pas fitores ndaj Irlandës: Tani synojmë triumfin dhe pikët e plota ...



Statistikat e ndeshjes Kosovë-Irlandë: "Dardanët" dominuan dhe morën...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.